



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-163
Prishtinë, më 23 prill 2014

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23 PRILL 2014**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari, Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryetari në vazhdim i njoftoi deputetët se në ndërkohë, më 22 prill 2014, Qeveria e ka proceduar në Kuvend edhe Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë.

Andaj, në pajtim me marrëveshjen e arritur në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, me kryetarët e grupeve parlamentare, mbajtur më 18 prill 2014, propozoj që të radhitet për shqyrtim, në seancën e sotme plenare, si pikë e parë e rendit të ditës.

Ndërsa si pikë nr. 2. e rendit të ditës, propozoj të jetë pika - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, tha kryetari.

Më pas, deputeti Behar Selimi, në emër të GP të PDK-së, ia paraqiti Kuvendit propozimin dhe arsyetimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, konform nenit 84 të saj, për shqyrtimin e dy pikave të lartpërmendura të propozuara edhe nga kryetari i Kuvendit.

Ai propozoi që votimi për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit të bëhet edhe për pikën - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, e cila do të bëhet në mbledhjen plenare të radhës për të cilën propozoi që ajo të mbahet më 23 prill 2014, në orën 16:00.

Diskutimi deputetit Behar Selimi është dhënë i plotë në transkript.

Në vazhdim kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimet e lartpërmendura.

Për propozimet e lartpërmendura diskutuan deputetët: Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sasha Gjokiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe Arsim Bajrami, Hydajet Hyseni, Adem Grabovci, si dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tutje kryetari hodhi në votim propozimet e lartpërmendura.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 113 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 93,
Kundër -----10,
Abstenime ----- 1.

Më pas, kryetari konstatoi:

I. Kuvendi e miratoi propozimin për shmangie sipas nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, për shqyrtim në këtë mbledhje plenare të dy pikave, si në vijim:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, dhe
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

II. Kuvendi e miratoi propozimin për shmangie sipas nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, për shqyrtim në mbledhjen plenare të radhës, e cila do të mbahet sot pasdite, në orën 16, me pikën e vetme të rendit të ditës - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

* * *

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës,

* * *

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Kryeministri Hashim Thaçi tha se së pari dua të bëj të qartë se kërkesa e bashkësisë ndërkombëtare ndaj Kosovës për ta themeluar një gjykatë speciale e cila do ta trajtojë ndonjë akuzë të mundshme, e cila do të mund të rezultojë nga hetimet e Task-forcës speciale hetuese, e themeluar nga Bashkimi Evropian për t'i adresuar pretendimet e dala nga raporti i Dik Martit, është padrejtësia dhe fyerja më e madhe që mund t'i bëhet shtetit të Kosovës dhe shoqërisë kosovare.

Qytetarët e Kosovës, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka zhvilluar luftë çlirimtare për çlirimin e Kosovës nga okupimi i regjimit të Slobodan Milosheviqit. Lufta jonë ka qenë e drejtë dhe në përputhje me normat ndërkombëtare të luftës.

Pikërisht për shkak të kësaj, ne jemi ndihmuar edhe nga shtetet aleate të NATO-s dhe kemi arritur të fitojmë luftën. Ne, nuk kemi bërë luftë pushtuese, por çlirimtare.

Kosova nuk ka qenë dhe nuk është boshti i së keqes në Ballkan. Dihet shumë mirë, dhe ju e dini shumë mirë se si është përgatitur raporti i Dik Martit. Dihet shumë mirë se kush e ka financuar dhe për çfarë arsye është bërë. Po ashtu është e qartë se lidhur me pretendimet e raportit të Dik Martit janë bërë disa herë hetime ndërkombëtare, të cilat i kanë hedhur poshtë ato pretendime.

Janë zhvilluar edhe gjykime ndaj figurave të shquara të UÇK-së, dhe është dëshmuar pafajësia. Ne e kemi pranuar formimin e Task-Forcës së Bashkimit Evropian apo SITF-it për të hetuar lidhur me pretendimet e raportit të Dik Martit dhe krejt kjo është bërë nën ombrellën e Bashkimit Evropian, saktësisht të EULEX-it. Institucionet e Kosovës, konkretisht Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë tërësisht e përjashtuar nga puna e Task-forcës.

Tani institucionet e Kosovës janë të ballafaquara me një imponim krejtësisht jo të ndershëm dhe jo të drejtë nga bashkësia ndërkombëtare.

Kërkohej nga ne të nxjerrim ligje të veçanta, bile ta ndërrojmë edhe Kushtetutën e Kosovës, vetëm e vetëm që të mundësojmë krijimin e një gjykate speciale, e cila do të gjykojë ndonjë rast të mundshëm, i cili mund të rezultojë nga hetimi i SITF-it lidhur me pretendimet e Dik Martit. Është një gjë shumë e vështirë, e cila do të rëndojë në ndërgjegjen tonë derisa të jemi gjallë për secilin nga ne. Por, ndërgjegjja jonë do të mbetet e njollosur në rast se ne nuk i japim përgjigje

adekuate kërkesës së BE-së dhe SHBA-së për themelimin e gjykatës speciale për t'i trajtuar pretendimet për pretendimet e ngritura të raportit të Dik Martit, i miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2010. Ne, sa herë kemi qenë së bashku në momente të vështira, si lidhshmëri kosovare, gjithmonë kemi dalë faqebardhë. Kemi ditur ta gjejmë rrugën e duhur për të ecur përpara.

Unë kam besim se përsëri do të jemi në gjendje ta bëjmë të njëjtën rrugë dhe ta marrim vendimin e përbashkët si Parlament i Kosovës.

Besoj se partnerët tanë që i kemi pasur në krah në ditët më të vështira, pra Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, do të jenë përsëri në anën e drejtë, dhe do ta ndihmojnë Kosovën për ta pastruar këtë barrë të madhe që i është vënë në shpinë, krejt padrejtësisht. Në të njëjtën kohë, nuk do të lejojmë rishkrimin e historisë. Nuk do të lejojmë njollosjen e luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne duhet ta ruajmë, besimin e plotë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Bashkimin Evropian, sepse jemi zotuar t'i ndajmë të njëjtat vlera humane dhe civilizuese.

Fundja, ne e kemi vetëm një synim, integrimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO, dhe miqësinë e përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo nuk ka alternativë.

Për ta arritur këtë objektiv, ne duhet ta kalojmë këtë sfidë të padrejtë të radhës, duhet ta kalojmë bashkërisht, duhet ta pastrojmë emrin e Kosovës nga pretendimet e bëra të padrejta në raportin e Dik Martit.

Dhe, sot nuk kemi shumë opsione. Në fakt, e kemi vetëm një opsion dhe ai është që të bashkëpunojmë ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian, NATO-n dhe ta formojmë këtë gjykatë speciale, e cila do të jetë nën juridiksionin e Kosovës, dhe një seli do ta ketë në Kosovë dhe një tjetër jashtë Kosovës, ku do të zhvillohen procedurat të ndjeshme që ndërliken me dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtur.

Ky është opsioni i vetëm, deputetë të nderuar, i cili është shumë i vështirë, por ky opsion na mundëson që gjykata të funksionojë me ligjet e Kosovës dhe në partneritet me Bashkimin Evropian dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Opsioni i dytë, të nderuar deputetë, qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilin nuk duhet as ta marrim në konsiderim fare, është ai që të refuzojmë themelimin e kësaj gjykate.

Refuzimi eventual i themelimit të gjykatës nga Kuvendi i Kosovës, përpos që do të forconte dyshimet se Kosova po pretendon ta pengojë dhe ta fshehtë verifikimin e pretendimeve që përmban raporti, kjo do të kishte pasoja tjera të rënda politike për Kosovën në arenën ndërkombëtare.

Një veprim yni i tillë negativ eventual do t'i mundësonte Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që në mungesë të vetos nga shtetet mike të Kosovës, ta miratojë një rezolutë për Kosovën për themelimin e një Tribunali ndërkombëtar për Kosovën, nën ombrellën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të gjykuar pretendimet e Dik Martit. Një gjë e tillë do të kishte pasoja historike për Kosovën dhe për imazhin e saj në arenën ndërkombëtare.

Unë ju ftoj, të nderuar deputetë, të gjitha partive politike dhe etnive që jeni sot në Kuvendin e Kosovës, që të votojmë pro ratifikimit të kësaj marrëveshje dhe themelimit të Gjykatës Speciale të Kosovës për të trajtuar pretendimet e raportit të Dik Martit të Këshillit të Evropës.

Diskutimi i kryeministri Hashim Thaçi është dhënë i plotë në transkript.
Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Petar Miletiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Faton Topalli, Hydajet Hyseni, Rada Trajkoviq, Lumnije Morina, Emilija Rexhepi, Vesna Mikiq, Arsim Bajrami, Alma Lama, Rexhep Selimi, Fatmir Limaj, Albin Kurti, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Gjokiq, Halit Krasniqi, Visar Ymeri, Agim Kuleta dhe Berat Buzhala, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 114 deputetë, ndërsa miratimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes kërkon votën e së paku dy të tretave të deputetëve të Kuvendit.

Kryetari e hodhi në votim projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----89,
Kundër -----22 ,
Abstenime -----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Ligji nr.04/L-274 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë.
2. Ligji i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje.

* * *

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi tha se ky projektligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve lidhur me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë EULEX, si në vijim:

1. Ligjit nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
2. Ligjit nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë;
3. Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nr. 04-L/082;
4. Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nr. 04-L/123;
5. Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
6. Ligjit nr. 03/L-137 për Departamentin e Mjekësisë Ligjore;
7. Ligjit nr. 04/L015 për mbrojtjen e dëshmitarëve;
8. Kodin doganor dhe të akcizave të Kosovës, nr. 03/L-109.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Diskutimi i ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi Xhavit Haliti hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, dhe Berat Buzhala, Hydajet Hyseni, Nijazi Idrizi, Glauk Konjufca, Albulena Haxhiu, Faton Topalli, Visar Ymeri, si dhe ministri Hajredin Kuçi diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 85,
Kundër -----14,
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet, në parim, Projektligji nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

2. Ngarkohet Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, që ta shqyrtojë projektligjin e lartshënuar dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

* * *

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i përfundoi punimet për ditën e sotme dhe i mbylli punimet në orën 14:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesmbajtës:

Selman Ymeri, zyrtar i lartë ligjor